



This project is funded
by the European Union



Fushata e ndërgjegjësimit “Nga e para”

- E GJITHË VËMENDJA TEK TË MBIJETUARAT E TRAFIKIMIT
DHE DHUNËS NË FAMILJE



MJETET NDËRGJEGJËSUESE:

- Harta Shërbimi
- Etiketa kafeje me mesazhe ndërgjegjësuese
- Sesione informuese
- Ekspozita me piktura
- Fushatë në mediat sociale (Video, Blog etj.)

Ideimi dhe Realizimi i Fushatës

Fushatë e iniciuar nga anëtarët e AAGW

Një grup vajzash dhe grash, të mbijetuarat trafikimi dhe dhune në familje punuan gjatë periudhës Shkurt – Prill 2020 për të dhënë jetë fushatës ndërgjegjësuese nga “NGA E PARA”, me mbështetjen e projektit “Bashkëpunimi ndërmjet OSHC-ve dhe grupeve të ish-viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje për fuqizimin ekonomik të viktimave”, zbatuar nga organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” (D&E) në bashkëpunim me “Qendrën për Familjen dhe Fëmijën”, mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian. Ideja për fushatën erdhi nga vetë të mbijetuarat me dëshirën për të treguar rëndësinë e shërbimeve riintegruese afatgjata dhe gjithëpërfshirëse për çdo të mbijetuar trafikimi apo dhune në familje, për t’ju rikthyer atyre shpresën e humbur dhe kurajon për të ndërtuar jetën pas eksperiencës që kanë kaluar. Fushata targetonte pikërisht ato vajza dhe gra që mund të jenë duke përjetuar dhunë apo abuzim, apo gjenden në kthetrat e trafikimit. Aktivitetet dhe mjetet ndërgjegjësuese të ideuara për fushatën ishin të thjeshta dhe direkte për të arritur sa më lehtë të grupi i synuar.



Harta të vogla shërbimesh, u ideuan për t'ju ardhur në ndihmë të gjitha vajzave dhe grave që banojnë në qarkun e Tiranës, Dibrës, Kukësit dhe Bashkisë Sarandë (që janë edhe zonat ku zbatohet projekti), të cilat ndihen të rrezikuara pasi janë duke përjetuar abuzim, shfrytëzim dhe dhunë të formave të ndryshme. Kontaktet kryesore të numrave të emergjencës, të ofruesve kryesorë të shërbimit publik dhe jo publik të qarkut/ bashkisë përkatëse janë pjesë e hartave.



Në kuadër të fushatës në datën 3 Mars një sesion informimi u realizua në ambientet e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja. Sesioni u fokusua në dimensionet e fenomenit të dhunës në familje në shoqërinë shqiptare dhe në rëndësinë e ofrimit të shërbimeve riintegruese gjithëpërfshirëse për viktimat e kësaj dhune. 61 studentë ishin pjesë aktive e sesionit. Disa studente të këtij fakulteti vendosën ti bashkohen me tej fushatës duke realizuar disa video ndërgjegjësuere mbi historinë e të mbijeturave të dhunës në familje dhe duke inkurajuar vajzat dhe gratë të mos lejojnë askënd të vendosë për jetën e tyre.

Gjatë javës së parë të Marsit 9 Bar- Kafe të qytetit të Tiranës ju bashkuan fushatës “Nga e Para” duke shpërndarë për klientët e tyre letra të vogla me mesazhe dhe shprehje kuptimplota nga të mbijetuarat e trafikimit dhe dhunës në familje.



Vajzat dhe gratë që punuan për fushatën “Nga e Para” zgjodhën edhe artin si mjet për të përcjellë zërin dhe shpresën e tyre për një rifillim të ri, një jetë të re duke realizuar një ekspozitë me piktura të realizuara nga vetë ato.

Ekspozita u realizua në ambientet e Shtëpisë së Evropës, në datën 9 Mars. Duke u bërë pjesë e një game të plotë aktiviteteve ndërgjegjësuere të realizuara atë ditë në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Grave, organizuar me kujdesin e veçantë të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, nën sloganin e përbashkët “Unë JAM BREZI i Barazisë Gjinore – Të përmbushim të drejtat e grave”.



AFEKTIMI PREJ PANDEMISË GLOBALE

Ndryshimi i fokusit të Fushatës Ndërgjegjësuere

Por afektimi i Shqipërisë nga pandemia globale Covid-19 dhe masat e marra nga qeveria shqiptare për mbrojtjen e shëndetit publik dhe minimizimin e përhapjes së virusit solli pamundësinë e realizimit të disa aktiviteteve të planifikuara për fushatën të tilla si: sesione informimi me vajza dhe gra që punojnë në fasoneri, transmetimi në monitorët e autobuzëve të transportit publik të qytetit të Tiranës të 3 videove ndërgjegjësuere mbi dhunën dhe abuzimin/ mënyrat e raportimit të kësaj dhune (të cilat u shpërndanë më tej gjerësisht në mediat sociale) etj; duke çuar kështu gradualisht në nevojën e ndryshimit të fokusit të fushatës ndërgjegjësuere “NGA E PARA”.

“

Shumë i rëndësishëm u konsiderua informimi i vazhdueshëm, ditë pas dite i viktimave mbi situatën e pandemisë në vend, këshillave praktike si të mbrojnë shëndetin, si të përballojnë stresin dhe ankthin për shkak të distancimit social, si të krijojnë një plan sigurie për veten dhe fëmijët e tyre, ku të kërkojnë ndihmë në rast situatë emergjente, si të aplikojnë për të përfituar nga paketat e mbështetjes së qeverisë etj



Vulnerabiliteti i viktimave të trafikimit rritet për shkak të pandemisë globale Covid-19

te_ndryshem_dhe_te_barabarte

E: si por çfare mund të bëj?

Era: E ke telefonuar policinë? ☎️112

Kam frikë... Gjykatat janë mbyllur, kush do më japë urdhër mbrojtje?

Era: Ato funksionojnë për raste urgjente sic është Urdhëri i Menjëherëshëm i Mbrojtjes

Jam shumë keq...

Era: Ke provuar te telefonosh ☎️116 117 -Linjën Kombëtare të Këshillimit?

Jo por e

KUSH JANË KATEGORITË QË PËRFITOJNË NDIHMË FINANCIARE PËR SHKAK TË SITUATËS SË KRIJUAR NGA COVID-19?
CILAT JANË FORMAT E NDIHMËS?

Në kuadër të fushatës, mesazhe motivuese dhe shprese u përcollën për të mbijetuarat e trafikimit dhe dhunës në familje për t'ju rikujtuar se edhe në periudhë pandemie viktimat nuk duhet dhe nuk mund të heshtin dhe se përtej vështirësive me të cilat përballen çdo ditë nuk janë vetëm në betejën e tyre.

Audienca e arritur me anë të mjeteve të ndërgjegjësimit të shpërndara në median sociale ishte 6684 individë. Gjatë periudhës Mars- Prill me anë të rrjeteve sociale na kontaktuan për të kërkuar ndihmë për shkak të situatës së vështirë me të cilën po përballeshin për shkak të pandemisë, 23 vajza dhe gra viktimat të dhunës në familje dhe viktimat të mundshme trafikimi. Nevojat e tyre u vlerësuan dhe adresuan menjëherë nga stafi i organizatës “Të Ndryshëm & Të Barabartë”.

Për të parë mjetet e ndërgjegjësimit të fushatës ju lutem vizitoni faqen tonë në Facebook dhe Instagram:



@Different&Equal



@tendryshemdhetebarabarte